



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - Competition Authority of the Republic of Kosovo



Vendimi Nr. 22/23

Data: 24.02.2023

Duke u bazuar në nenet 26, 27 dhe çështjet procedurale të përcaktuara sipas nenit 4, 5, 11, 13, 15, 16, 17, 18, 35, 51 dhe 55 paragrafi 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 24.02.2023, mori këtë:

## V E N D I M

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve Pivovarna Lasko Union d.o.o (*shitësi*), Nika Bev d.o.o (*blerësi*) për blerjen e markave tregtare Sola dhe Zala.

**Nika Bev d.o.o**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në pajtim me legjislacionin Slloven, me seli në Ljublanë dhe adresë biznesi në Trg republike 3, 1000, Ljublanë, me numër të regjistrimit të biznesit 9284486000.

**Pivovarna Lasko Union d.o.o**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në pajtim me legjislacionin Slloven, me seli në Ljublanë dhe adresë biznesi në Pivovarniska ulica 2, 1000, Ljublanë, me numër të regjistrimit të biznesit 5049318000.

**II.** Parashtuesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (*njëqind Euro*) dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (*tre mijë Euro*).

## A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 17.01.2023, me Nr. Prot. 29/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit përmes znj. Mrika Gashi Përfaqësuese Ligjore nga Tashko Pustina, lidhur me Blerjen/Përvetësimin e Markave Tregtare Sola dhe Zala të Pivovarna Lasko Union d.o.o nga Nika Bev d.o.o.

## Procedurat e ndjekura:

Autoriteti i Konkurrencës  
Adresa: Ish Banka e Ljubjanës – Rr. Migjeni, Prishtinë, Kati i VI, zyra nr. N.1 Tel: +381 0 38 200 100 73

1. Vlerësimi i Lëndës/dokumentacionit
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 31.01.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKRK-së me dt. 24.01.2023
4. Më dt. 28.12.2022, palët kanë nënshkruar Kontratën për Blerjen/Përvetësimin e Markave Tregtare Sola dhe Zala, të Pivovarna Lasko Union d.o.o (shitësi) dhe Nika Bev d.o.o (blerësi).

#### **Baza juridike:**

Sipas neni 11 par. 3.1, neni 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000.00 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000.00 Euro.
- c) “Nika Bev” do të bëjë Blerjen e Markave Tregtare Sola dhe Zala të Pivovarna Lasko Union d.o.o
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 28.12.2022
- e) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se shitësi është prezent në Kosovë.

#### **Vlerësimi i Konkurrencës**

**Tregu Relevant:** Struktura e Lasko Union në tregun e Republikës së Kosovës, nuk ndryshon.

**Tregu i produktit** - është prodhimi dhe shitja e pijeve të ndryshme, alkoolike dhe joalkoolike

**Tregu gjeografik** - Tregu gjeografik përkufizohet territori i Republikës së Kosovës.

#### **Tregjet e Prekura**

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që blerësi nuk është aktiv në Kosovë pra nuk ka një filial të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe nuk është prezent as përmes shitjes, ndërsa pala shitëse është prezentë në Kosovë. Markat tregtare Sola dhe Multi Sola janë brende të Lasko Union, të cilat janë të regjistruara në Kosovë dhe janë të licensuara përmes një marrëveshje licence për market tregtare me Birra Peja JCS.

#### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Sllovenisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala shitëse është prezente në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë dhe si e tillë nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**Komisioni**

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare



Nafije Osdatuaj  
Anëtare



Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva